

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Tregëtia ndërkombëtare dhe e drejta e investimeve
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti I, Semestri II
Numri i orëve në javë:	2+0
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	Salla D4
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Dr. Mejdj Bektashi
Detajet kontaktuese:	meidi.bektashi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p><i>Tregtia ndërkombëtare gjatë zhvillimit të shoqërisë njerëzore ka luajtur një rol qendror në përvojën dhe zhvillimet historike të botës në zhvillim.</i></p> <p><i>Tregtia ndërkombëtare është një stimulus i rëndësishëm dhe i pashmangshëm në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të shteteve të ndryshme. E njëjta zgjeron kapacitetet konsumuese të një shteti, rritë prodhimin vendor dhe ate global, por dhe siguron në mënyrë të efektshme qasjen në burimet e pamjaftueshme dhe tregjet botërore të produkteve pa të cilat shtetet në zhvillim nuk do të ishin në gjendje të zhvillohen. Por, nga ana tjetër, tregtia ndërkombëtare duhet të kuptohet në një perspektivë më të gjerë sesa thjesht rrjedha ndërshtetërore e burimeve të mallrave, shërbimeve dhe investimeve. Nga hapja me kohë e ekonomive dhe shoqërive të tyre ndaj tregtisë globale, shtetet në zhvillim tërheqin jo vetëm transferin ndërkombëtar të të mirave, shërbimeve dhe investimeve, por gjithashtu edhe ndikimet zhvillimore të transferit të teknologjive të prodhimit; sistemeve arsimore dhe shëndetësore; dhe sistemeve sociale; por dhe vlera më të përgjithshme të modeleve të avancuara dhe jetesës së shteteve më të zhvilluara të botës.</i></p>
Qëllimet e lëndës:	<p><i>Objektivi kryesor i lëndës është të zgjerojë dhe thellojë të kuptuarit dhe njohuritë e studentëve për teoritë e ndryshme mbi tregtinë ndërkombëtare, investimeve direkte të huaja si dhe financimin e jashtëm. Studentët do të jenë në gjendje të kuptojnë funksionimin praktik dhe logjikën teorike të ndërlidhjes në mes të tregtisë ndërkombëtare, investimeve të huaja dhe zhvillimit</i></p>

	<p><i>ekonomik në një anë dhe mjedisit në anën tjetër. Studentët gjithashtu do të jenë në gjendje të kuptojnë dhe shumë nocione të rëndësishme siç janë: roli dhe rëndësia e ekonomisë së shkallës (vëllimit), teknologjisë, ofertës dhe kërkesës, kostove të transportit, kostove të prodhimit, avantazhet komparative, modelet e tregëtisë, përfitimet nga tregëtia, proteksionizmi dhe efektet e tregëtisë në shpërndarjen e të ardhurave etj. si dhe ndikimin e politikave ekonomike në avancimin ose shtrengimin e tregtisë ndërkombëtare.</i></p> <p><i>Objektivi tjetër shumë i rëndësishëm është analiza e kornizës ligjore, në aspektin krahasues, që ka për qëllim rregullimin e marrdhënieve reciproke në mes të investitorëve të huaj, në një anë dhe shtetit dhe bizneseve vendore, nga ana tjetër.</i></p>
<p>Rezultatet e pritura të nxënies:</p>	<p><i>Aftësitë dhe shkathtësitë që do t'i fitojnë studentët pas përfundimit të sukseshëm të kësaj lënde, është që:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <i>• Të fitojnë njohuri adekuate për rëndësinë dhe rolin që ka tregtia ndërkombëtare dhe investimet e huaja për zhvillimin ekonomik dhe mirëqenjen e një kombi;</i> <i>• Të fitojnë njohuri të mjaftueshme për të kuptuar ndërvarësinë, ndërlidhjen dhe rolin kritik që luan tregëtia ndërkombëtare në rritjen, zhvillimin dhe forcimin ekonomik të shtetit, si dhe rëndësinë dhe rolin e sistemit juridik në rregullimin e këtyre aktiviteteve shumë të rëndësishme;</i> <i>• Të kuptojnë dhe të dinë që ti shpjegojnë termat parësore që ndërlidhen me tregtinë ndërkombëtare, fushën e investimeve dhe investimeve të huaja direkte si dhe rolin e shtetit në këto aktivitete ekonomike;</i> <i>• Të kuptojnë çështjet e rëndësishme aktuale nga fushat e politikave tregtare, pasi që eksperiencia botërore ka treguar se politikat tregtare kanë luajtur një rol të rëndësishëm në drejtim të nxitjes së eksporteve dhe rritjes ekonomike;</i> <i>• Të fitojnë njohuri adekuate për rëndësinë dhe rolin që kanë investimet e huaja, pasi që legjislacioni i çdo shteti ka për qëllim që të rregullojë mbrojtjen, promovimin dhe inkurajimin e investimeve të huaja, por dhe tu ofrojë investitorëve të huaj të drejta dhe garanci themelore, që u japin siguri investitorëve të huaj që investimet e tyre të mbrohen dhe të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe në pajtim me standardet dhe praktikatat e pranuar ndërkombëtare.</i>

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxëniet të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	15	30
Ushtrime në teren			
Kollokfiime,seminare	1	2	2
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	4	16
Përgaditja përfundimtare për provim	6	2	12
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	5	2	10
Totali			100 orë
Metodologjia e mësimdhënies:	<p><i>Lënda do të organizohet në formë të ligjeratave, diskutimeve dhe konsultimeve. Studentët duhet të jenë pjesëmarrës aktivë të procesit mësimor. Mësimi aktiv kërkon që studentët të reflektojnë mbi gjërat që diskutohen e jo të jenë pranues pasivë të informatave që u jepen. Ata janë të inkurajuar që të shtrojnë pyetje. Nga studentët paraprakisht do të kërkohet leximi dhe thellimi në literaturën relevante për temat e specifikuar të lëndës.</i></p>		
Metodat e vlerësimit:	<p><i>Vlerësimi i studentëve konsiston në dy metoda:</i></p> <p>1. Vlerësimi i vazhdueshëm: Studentët do të vlerësohen gjatë gjithë semestrit përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <i>Vlerësimi fundsemestral përmes testit: 90%</i> ▪ <i>Pjesëmarrja e rregullt në liqjërata, anqazhimi në diskutime dhe prezantimi: 10%.</i> <p>2. Provimi final: Studentët që nuk kanë arritur të kalojnë me sukses vlerësimin e vazhdueshëm ose nuk kanë marrë pjesë në të, duhet t'i nënshtrohen provimit final gjatë afatit të provimeve.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <i>Provimi final: vlerësohet me 100%.</i> <p>Shënim: Studentët që zgjedhin/kalojnë me sukses vlerësimin e vazhdueshëm dhe janë të kënaqur/pranojnë notën e kollokfiomit lirohen nga pjesëmarrja në provimin final.</p>		
Literatura			
Literatura bazë:	<p>1. Paul R. Krugman and Maurice Obstfeld: <i>International Economics, Theory and Policy, 7th Edition, Pearson Education, 2006.</i></p>		

	<p>2. <i>Dominick Salvatore: International Economics (Ninth Edition), 2014.</i></p> <p>3. <i>Robert Gilpin: Ekonomia politike globale, Kuptimi i rendit ekonomik ndërkombëtar, ISP&Dita 2000, Tiranë, 2009.</i></p> <p>4. <i>Michael P. Todoro & Stephen C. Smith: Economics Development, Botimi I 12, Pearson, 2015.</i></p>
Literatura shtesë:	<p>1. <i>Amartya Sen: Zhvillimi si liri, Tiranë, 2009.</i></p> <p>2. <i>OECD Benchmark definition of foreign investment, www.oecd.org.</i></p> <p>3. <i>Sornorojah, M.: "The International Law and Foreign Investment" Cambridge University Press, 1999.</i></p> <p>4. <i>Manfred B. Steger: Globalizimi – Hyrje e shkurtwr.Co-Plan, Tiranw, 2005.</i></p> <p>5. <i>Robert C. Feenstra, Advanced International Trade: Theory and Evidence, Princeton University Press, 2004, ISBN 0-691-11410-2.</i></p> <p>6. <i>Feenstra, Robert C., Advanced International Trade: Theory and Evidence, 2004, Princeton and Oxford: Princeton University Press, pp. xii, Advanced 484.</i></p>
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Ligjëratë hyrëse- prezantimi i syllabusit të lëndës
Java e dytë:	Paraqitja dhe historiku i zhvillimit të tregtisë dhe tregtisë ndërkombëtare; Ekonomia ndërkombëtare, Tregtia ndërkombëtare dhe Politika Ekonomike; Dobitë që i kanë individët dhe shtetet nga pjesëmarrja në Tregtinë Ndërkombëtare.
Java e tretë:	Pse shtetet (kombet) tregtojnë në mes tyre? Çështjet parësore në TN; Ndarja e punës dhe specializimi, kufizimet dhe dobitë; Dallimet në mes tregisë së brendshme dhe të jashtme; Teoritë e ndryshme–qasja në tregtinë ndërkombëtare; Zhvillimi historik i teorisë të tregtisë ndërkombëtare;
Java e katërt:	Merkantilizami, Fiziokratizmi; Teoria e përparësive absolute; Teoria e përparësive komparative; Teoria klasike dhe neoklasike e Tregtisë Ndërkombëtare; Teoritë moderne të tregtisë ndërkombëtare; Teoria e Kravisit; Teoria e gepit (hendekut) teknologjik;
Java e pestë:	Teoria e ciklit jetësor të produktit; Teoria e ngajshmërisë së shteteve; Teori e mbështetur në ekonominë e vëllimit; Teoria e tregtisë në kushtet e oligopolit; Teoria e gjeografisë ekonomike; Teoria e kontrollit të pronësisë intelektuale; Teoria e përparësive konkurruese; Teoria e rivalitetit strategjik global.
Java e gjashtë:	Konceptet e ndryshme mbi Tregtinë Ndërkombëtare; Konceptet protekcioniste dhe ato liberale për tregtinë e lirë; llojet e politikave tregtare; Autarkia; Monopoli shtetëror i tregtisë së jashtme; Dobia nga liberalizimi.

Java e shtatë:	Instrumentet në tregtinë ndërkombëtare, Sipas llojit dhe mënyrës së veprimit; Klasifikimi i instrumenteve; Doganat, rëndësia, llojet, efektet dhe specifikat.
Java e tetë:	Barierat jo doganore, llojet, efektet dhe specifikat; Subvencionet eksportuese; Masat tradicionale – të rregulluara në kuadër të OBT-së; Barrierat teknike dhe administruara në kuadër të Tregtisë Ndërkombëtare; Barrierat teknike në tregtinë ndërkombëtare.
Java e nëntë:	Instrumentet ndaluese në Tregtinë Ndërkombëtare; Bojkoti, embargo, Bllokata ekonomike dhe Sankcionet ekonomike dhe financiare; Instrumentet tjera teknike, ekologjike dhe Domosdoja e përmbajtjes vendore.
Java e dhjetë:	Kufizimet jo doganore të Tregtisë Ndërkombëtare; Kuantitative dhe Kualitative; Kuotat; normat, atestet, shenimi i produkteve; Veprimet damping dhe antidumping.
Java e njëmbëdhjetë:	Zhvillimi historik i tregtisë ndërkombëtare; Kuptimet bazike dhe evoluimi; Globalizimi ekonomik–integrimi; Faktorët e globalizimit; Zhvillimi i politikave tregtare bashkëkohore; Argumentet për protekcionizëm dhe tregti të lirë; Mospajtimet rreth politikave tregtare.
Java e dymbëdhjetë:	Institucionalizimi i tregtisë ndërkombëtare; Marrëveshja e përgjithshme për Dogana dhe Tregti (GATT); rëndësia dhe shëndërrimi i të njejtës në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT); Marrëveshjet e OBT-së; Përparësit e OBT-së në krahasim me GATT-in;
Java e trembëdhjetë:	Organet menaxhuese dhe drejtuese të OBT-së; Parimet e vendimarrjes; Politikat tregtare dhe OBT-ja; Politikat tregtare dhe të investimeve në Republikën e Kosovës; Rëndësia e Koorporatave multinacionale për Tregtinë Ndërkombëtare dhe tërheqjen e investimeve të huaja.
Java e katërbëdhjetë:	Definimi i investimeve të huaja direkte (IHD), nocioni, rëndësia dhe efektet; Korniza ligjore për IHD në Republikën e Kosovës dhe krahasimi me legjislacionet e shteteve të tjera; Ligji për Investime Strategjike; Trendi i IHD-ve në dekadën e fundit. Politikat tregtare dhe Kosova; CEFTA dhe Kosova; Investimet e Huaja Direkte dhe Kosova; Faktorët që pengojnë tërheqjen e IHD, Analiza komparative sa i përket politikave tregtare dhe IHD; Definimi juridik i IHD; Teoria ekonomike e IHD; Investimet portfolio; Format e reja të investimeve.
Java e pesëmbëdhjetë:	<i>Vlerësimi fundsemestral përmes testit</i>
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<p>Sjelljet e poshtëshënuara janë në kundërshtim me politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Vonesa në ligjerata dhe ushtrime;</i> • <i>Lëshimi i sallës gjatë ligjeratave ose ushtrimeve (pa arsyeje të nevojshme);</i> • <i>Tregimi i shenjave të qarta të mosinteresimit dhe të folurit të pandërprerë ose formave tjera të sjelljes që pengojnë procesin e rregullt të mësimi;</i> 	

- *Mbajtja e telefonit celular të hapur gjatë ligjeratave ose ushtrimeve, do të rezultojnë me humbje të pikëve për shkak të sjelljes joprofesionale.*

Shkelja e integritetit akademik përfshin një ose më shumë nga veprimet në vijim:

- *Kopjimi gjatë provimit ose testit;*
- *Shfrytëzimi i shenimeve ose librave të palejuara gjatë testit ose provimit;*
- *Shkëmbimi i informatave me një student tjetër gjatë provimit;*
- *Dhënja e deklaratave të rrejshme për të arsyetuar dikë nga mësimi, ushtrimi apo provimi.*